




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 06.12.2017

Vendim
Nr. 101, datë 06.12.2017

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN NË UV TË PLATFORMËS DIGJITALE
"SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT MËSIMOR TË UV"
ME AKRONIMIN: UVMS (University of Vlora Management System)

Në mbështetje të pikës 1 dhe pikës 2/a të nenit 3, pikës 1/a të nenit 38, të pikës 2 dhe 3 të nenit 66, të pikës 1/b të nenit 98, të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në vijim të modernizimit të procesit mësimor dhe përmirësimit të shërbimeve digjitale ndaj studentëve, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.12.2017, pasi mori në shqyrtim relacionin propozues të Zëvendësrektorit për Zhvillim Institucional dhe Komunikim Phd. Enkelejd Mëhilli, Drejtorit të IT-së dhe Statistikave, Z. Altin Mahilaj dhe Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Znj. Fabiola Pashaj, "Për krijimin dhe funksionimin në UV të platformës digjitale 'Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Mësimor të UV', me akronimin: UVMS (University of Vlora Management System)"

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin dhe funksionimin në UV të Platformës Digjitale "SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT MËSIMOR TË UV, ME AKRONIMIN: UVMS (University of Vlora Management System)".
2. UVMS (University of Vlora Management System) të fillojë të funksionojë menjëherë pas miratimit të këtij vendimi. Drejtoria e IT-së dhe Statistikave të fillojë veprimtarinë për implementimin në praktikë të UVMS (University of Vlora Management System).
3. Drejtoria e IT-së dhe Statistikave dhe Drejtoria Juridike të hartojnë Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të UVMS (University of Vlora Management System) dhe ta dorëzojnë për miratim në SA brenda datës 15. 12. 2017.
4. Vendimi i SA "Për krijimin dhe funksionimin në UV të Platformës Digjitale 'SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT MËSIMOR TË UV', ME AKRONIMIN: UVMS (University of Vlora Management System)", t'i përcillet BA për shqyrtim dhe miratim.
5. Vendimi protokollohet, arkivohet dhe u dërgohet për njohje dhe zbatim gjithë studentëve, personelit akademik, departamenteve, kryesekretarive, sekretarive




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

mësimore dhe çdo njësie apo specialisti, në fakultete apo rektorat, që ndihmon dhe mbështet procesin mësimor në UV.

6. Për monitorimin dhe zbatimin e mëtejshëm të këtij vendimi nga njësitë e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi ngarkohen: Zv/rektori për Zhvillim Institucional dhe Komunikim, Dekanët e fakulteteve, Drejtoria e IT-së dhe Statistikave dhe Drejtoria Juridike.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.